



**Consolato d'Italia  
Scutari**

**KURE MJEKESORE**

Dokumente qe duhet te paraqiten:

- **Pashaporta**  
(Pashaporta duhet te jete e vlefshme te pakten tre muaj mbas skadences se vizes se kerkuar; pashaporta duhet te jete e firmosur nga titullari).
- **Fotokopje e pashaportes**
- **1 fotografi**
- **Formulari i plotesuar ne çdo pjese te tij**
- **Epikrize**  
Origjinali dhe fotokopja e diagnozes leshuar nga Qendra Spitalore Universitare "Nene Teresa" e perkthyer dhe e noterizuar.
- **Deklarate e Struktures Spitalore italiane, publike ose private te akredituar (nga ASL), ku te cilesohet:**
  - Lloji i kures mjeksore;
  - Data e fillimit dhe kohezgjatja e parashikuar e kurimit si dhe kostoja e mundshme e tij. Nuk mund te merren ne konsiderate kerkesat per vize qe kane te bejne me struktura private te pa akredituara, edhe kur i huaji merr persiper plotesisht koston e kurimit.
- **Vertetimi i kesaj strukture shendetesore qe konfirmon depozitim** e kryer te nje shume si garanci, ne Euro, e barabarte me te pakten 30% te koston totale, ose te asaj te parashikuar, per sherbimet shendetesore te kerkuara. Njoftojme se NUK do te merren parasysh vertetimet e strukturave spitalore ose te leshuara direkt nga Ndermarrjet Shendetesore publike, ne te cilat nuk tregohet kostoja - perfundimtare ose ajo e parashikuar - e kurimit, apo qe ku deklarohet se trajtimi se cilit do t'i nenshtrohet qytetari i huaj eshte i "formes falas". Trajtimi mjekesor falas duhet te jete i autorizuar dhe i vertetuar nga Ministria e Shendetesise italiane dhe vetem ne kuadrin e Programeve humanitare te parashikuara nga legjislacioni.
- **Dokumentacioni qe verteton disponibilitetin ne Itali** te burimeve te mjaftueshme per pagesen e pjese tjeter te shpenzimeve shendetesore dhe te atyre per ushqim dhe strehim jashte struktures sanitare dhe te shpenzimeve te kthimit ne atdhe te te asistuarit apo te personit qe mund ta shoqeroje. Nje nxjerrje llogarie ose deklarate nga banka per pjesen tjeter te mbetur (70%).
- Ne rast se shpenzimet mjekesore jane formalisht te mbuluara nga Ente publike ose private me kredibilitet te garantuar, nuk do te nevojitet natyrisht vertetimi i struktures sanitare qe verteton derdhjen e 30% te koston totale dhe as dokumentacioni qe verteton zoterimin e burimeve ekonomike te mjaftueshme ne Itali per pagesen e shpenzimeve mjeksore dhe te shpenzimeve per ushqim e strehim te te semurit dhe te shoqeruesit te tij.
- Ne rast se mbulimi i shpenzimeve mjekesore behet nga persona te trete (qytetar italian ose i huaj me banim te rregullt ne territorin kombetar italian), dokumentacioni lidhur me disponibilitetin ne Itali te burimeve te mjaftueshme per pagesen e shpenzimeve shendetesore, per ushqim dhe strehim, mund te perbehet nga nje "impenjim formal" me shkrim nga ana e garantit, dhe nga dokumentacioni bankar qe tregon zoterimin e mjeteve ekonomike te mjaftueshme.
- **Certifikate lindjeje, e perkthyer, e noterizuar dhe e legalizuar nga Ministria e Puneve te Jashtme shqiptare**

**NUK mund merren parasysh kerkesat per vize te shoqeruara nga deklaratat e Keshilltareve ose te Keshillave per Shendetesine te Rajoneve te ndryshme, qe vertetojne te qenurit falas (ose marrjen persiper te shpenzimeve) per trajtimin mjekesor te parashikuar.**

**Po keshtu nuk mund te merren ne konsiderate, per leshimin e vizave per kure mjeksore, deklaratat e thjeshta te leshuara nga vete Ndermarrjet Shendetesore Lokale (ASL) mbi**

disponibilitetin per te bere falas sherbimet mjekesore ne favor te qytetareve te huaj, pasi ofrimi i ketyre sherbimeve shendetesore ka padyshim nje kosto qe ndikon ne Fondin Shendetesor Kombetar.

### Shenime

- **Te miturit e shoqeruar**

Per te miturit e shoqeruar nga nje prind eshte e nevojshme te paraqitet certifikata familjare e perkthyer dhe e legalizuar ne Ministrine e Jashtme dhe deklarata e aprovimit te prinderit perkthyer ne italisht dhe e noterizuar. I mituri duhet te jete i regjistruar ne pashaporten e prindit qe e shoqeron.

- **Te miturit e pashoqeruar**

Per te miturit e pashoqeruar nga prinderit eshte e nevojshme te paraqitet certifikata familjare e perkthyer dhe e legalizuar ne Ministrine e Jashtme, deklarata e aprovimit te prinderve e perkthyer ne italisht dhe e noterizuar, si dhe pashaporta personale e te miturit

- **Personeli i specializuar dhe shoqeruesi**

Viza per kurim mjekesor mund t'i jepet edhe personelit te specializuar qe shoqeron te semurin ose familiarit qe do ta asistojte. Ne kete rast shoqeruesi duhet te paraqese dokumentat per vize turistike.

- **Vizita te specializuara**

Ne rast *vizite te thjeshte mjekesore* qe nuk kane nevojte per *trajtim mjekesor*, do te leshohet -ne rast plotesimi te kushteve dhe te kerkesave te percaktuara- vetem vize per "turizem" (shih tipologjine e vizes per "turizem") duke paraqitur konfirmimin e dates se takimit per viziten si dhe faturen e pageses se vizites.

### **I gjithe dokumentacioni i leshuar nga Autoritetet shqiptare, duhet te jete i perkthyer dhe i legalizuar nga Ministria e Puneve te Jashtme shqiptare.**

- a. Kujtojme se duke filluar nga data 01/10/2003, kerkuesi i vizes duhet te paguaje koston e saj qe ne momentin e paraqitjes se kerkeses, pavaresisht nga leshimi apo jo i mevonshem i vizes.
- b. Zyra rezervon te drejten per te kerkuar paraqitjen e dokumenteve te tjere te mundshem, ne shtese te atyre te treguar me siper, te cilet do te mbahen si te nevojshem, me qellim vleresimin e leshimit te vizes.
- c. Te gjithe dokumentet duhet te paraqiten ne origjinale dhe ne fotokopje.
- d. Kerkesat e mangeta nga dokumentacioni i mesiperme do te refuzohen menjehere ne sportel.